



## Asociacioni, zgjidhje afatshkurtër e BE-së

Një raport i Këshillit për Politika të Demokratizimit me seli në Berlin zbulon se “sipas një zyrtari të Bashkimit Evropian, drafti i dokumentit i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe në Kosovë ishte hartuar nga një jurist i Shërbimit të Jashtëm të BE-së (EEAS), i cili nuk kishte fare përvojë në fushën e qeverisjes lokale”.

### Vijon nga faqja e parë

Prandaj, është e qartë se forma dhe karakteri i Asociacionit do të varet nga përmbajtja e statutit të tij”, thuhet mes tjerash në këtë raport me titull: “Zhbërja e progresit? - Këmbimi i demokracisë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth statusit”.

Këshilli për Politika të Demokracisë në këtë raport ka analizuar në tërësi procesin deri tek arritja e marrëveshjes në Bruksel në mes të Prishtinës dhe Beogradit, përderisa marrëveshja cilësohet si e befasishme duke pasur parasysh qëndrimet e kundërta të palëve rreth çështjes së Asociacionit. Marrëveshja sipas raportit, ishte pasuar me interpretime kontradiktore nga palët, shoqëria civile e nga partitë opozitare në Kosovë.

“Megjithatë, asnjë nga këto interpretime nuk pasqyrojnë në mënyrë korrekte marrëveshjen e arritur për statutin e Asociacionit. Marrëveshja parasheh një Asociacion/Bashkësi të Komunave që nuk është OJQ e as Republika ‘Srbska’, por një zgjidhje unike, në mes të një entiteti autonom pa vazhdimësi territoriale dhe një formë klasike dhe një shkrirje vullnetare klasike e kompetencave të disa komunave pas një niveli të tretë të pushtetit në mes të nivelit qendror dhe lokal, e që mund të gjendet në shumë vende të Evropës”, thuhet në raport.

### Spekulimet për Thaçin dhe Veselin si të akuzuar të mundshëm të Speciales

Përpos Marrëveshjes për Asociacionin, në këtë raport flitet edhe për tërheqjen graduale të misionit të BE-së për sundim të ligjit, EULEX, dhe krijimi i Gjykatës Speciale në Kosovë, që, sipas raportit, kanë qenë dy procese kontradiktore me njëra-tjetrën, që i kanë shkaktuar dëme sundimit të ligjit në Kosovë dhe synimit të proklamuar nga Qeveria për të promovuar një gjyqësor të pavarur dhe efikas.

Misioni EULEX në Kosovë, sipas raportit, e ka ndryshuar mandatin vitin e kaluar ngase EEAS e kishte përshkruar gjendjen në sistemin gjyqësor të Kosovës shumë më mirë se që ishte realiteti në terren. Raporti thekson se gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it ndonëse nuk po merreshin në konsideratë nga Brukseli, kishte potencuar se kolegët e tyre vendorë ende nuk janë të gatshëm të merren me çështje të ndjeshme.

“Ata nuk mund të iniciojnë raste të nivelit të lartë. Nëse ne nuk i iniciojmë rastet, asnjë person i profilit publik nuk do të hetohet ndonjëherë. Politika e mosnjohjes së rasteve të reja është fitore e plotë për Qeverinë e Kosovës. E gjithë garda e

gjyqësor tani mund të ndihet e sigurt”, kishte thënë një gjykatës i EULEX-it.

Por pavarësisht kësaj, raporti thekson se përpjekjet e BE-së për të siguruar shumicën parlamentare të nevojshme për miratimin e mandatit të ri të EULEX-it mbetën nën hijen e një sfide shumë të madhe politike me Qeverinë e Kosovës dhe opozitën rreth krijimit të Gjykatës Speciale.

“Plani i BE-së dhe SHBA-ve për të krijuar një gjykatë diku jashtë Kosovës, në një nga shtetet anëtare të BE-së, por që formalisht do të ishte në kuadër të rendit kushtetues të shtetit të Kosovës, doli të jetë një përpjekje jo e lehtë. Qeveria në Prishtinë nuk tregonte gatishmëri për të mbështetur krijimin e Gjykatës, sepse ishin rritur spekulimet për listën e të akuzuarve të mundshëm e ku përfshiheshin edhe Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, shef i SHIK-ut dhe nënkryetar i PDK-së”, thuhet në raport.

Por pavarësisht mosgatishmërisë së Prishtinës, më 24 prill 2014, siç thuhet në raport, pas presionit të fuqishëm nga BE-ja dhe veçanërisht nga SHBA-të, koalicioni qeverisës me shumicë të thjeshtë parlamentare ratifikoi Marrëveshjen me BE-në për krijimin e Gjykatës Speciale, duke e votuar atë në pako bashkë me misionin e ri të EULEX-it.

### Intervenimi i ndërkom-bëtarëve në proceset politike

Raporti i cili përmban rreth tridhjetë faqe pos që analizon procesin e arritjes së marrëveshjes, analizon edhe mënyrën se si Perëndimi gjatë viteve të fundit ka këmbyer demokracinë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që ndërliken me statusin e Kosovës.

Teksa e potencon krijimin e koalicionit në nëntor të 2014-s në mes të LDK-së dhe PDK-së, raporti thekson se pavarësisht se ishte arritur marrëveshje mes dy subjekteve më të mëdha politike në Kosovë, kjo marrëveshje e kishte edhe dimensionin që lidhej me Perëndimin.

“Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, bëri publike kthesën spektakolare politike pas vizitës së zhvilluar në Berlin dhe Bruksel, ku mori mbështetjen e Zyrës së Kancelares Gjermane, deputetëve të partisë konservative në pushtet, Unionit Kristian Demokratik (CDU), dhe lidhësit të Partisë Popullore Evropiane (EPP), anëtare të së cilës janë CDU dhe LDK”, thuhet në raport.

Kjo marrëveshje sipas raportit, ishte hera e dytë që Perëndimi ndërmjetësoi marrëveshje koalicioni në mes të dy partive më të mëdha që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, me qëllim të tejkalimit të krizave politike dhe institucionale.